



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**P R O J E K T L I G J**

Nr. \_\_\_\_\_ / 2019

**P Ë R**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9918,**  
**DATË 19.5.2008, “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE**  
**NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Pas pikës 23, të nenit 3, shtohen pikat 23/1 dhe 23/2, me këtë përmbajtje:

“23/1. “Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.

23/2. “Publikimi elektronik” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.”.

**Neni 2**

Shkronjat “k” dhe “rr”, të nenit 8, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“k) administron *domain cc.TLD.al*, nëndomainet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për metodologjinë,

pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.”.

...

“rr) merr masat, që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendjeje të jashtëzakonshme, si dhe të garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të invidit si dhe çdo detyrim të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”.

### **Neni 3**

Pas pikës 2, të nenit 12, shtohet pika 3, me këtë pëmbajtje:

“3. AKEP-i bashkëpunon me AMA-n në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.”.

### **Neni 4**

Në nenin 137, të kreut III, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Nëse ofruesit e shërbimit të komunikimeve publike nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4, të këtij ligji.”.

### **Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**